



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:162233

Datë: 02.07.2024

Numri i dokumentit: 05885693

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr. 181/24

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu në çështjen penale kundër të pandehurit A. A. për shkak të veprës penale Heqja, apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3509/23, të dt.06.06.2024, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, më datë 10.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.3509/23 dt.06.06.2024,dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

A. A., i biri i **Z.**, i lindur me .. në fsh. S., Komuna P. ku edhe banon, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me datë 03.05.2023 në fsh. Ll., Komuna P. tek operatori ekonomik”A. P.” sh.p.k, i pandehuri me dashje ka ndërhyrë në pllombat (vulat zyrtare) të vendosura nga Inspektorati i Tregut - MINT me procesverbalin nr. ... të datës 17.11.2020 të cilët kanë bërë mbylljen e aparatit /dorëzës së rrjedhjes së GLN-së me numër të pllombave 02004 dhe 02005,

-me këtë ka kryer veprën penale Heqja, apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 39, 40, 43 dhe 406 par. 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 495 të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

I. Në shumën prej **dyqind (200) Euro**, të cilën i pandehuri detyrohet t'a paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, atëherë ky dënim me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë do ti caktohet një (1) ditë burgim.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) Euro ndërsa në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimin po ashtu shumën prej njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, sipas aktakuzës PP.II.nr.3509/23 dt.06.06.2024, ka akuzuar të pandehurin A. A. për shkak të veprës penale Heqja, apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherit ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me bazueshmërinë e akuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas shqyrtimit paraprak të aktakuzës si dhe provave në të cilat mbështetet aktakuza, gjeti se janë plotësuar kushtet e parapara nga neni 493 par. 1 të KPP-së, andaj konform nenit 495 të KPP-së, vendosi të pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 493 par. 1 të KPP-së, është përcaktuar se për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë dhënien e urdhrin ndëshkimor pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkëngjitura në shkresat e lëndës dhe atë: Procesverbali i inspektimit të hartuar nga inspektorët nr. ..., kërkesa për afat shtesë, e dt. 18.09.2020, përgjigja nga I.T e datës 01/10/2020, kërkesa për mbyllje të përkohshëm të GLN-së e dt. 13.10.2022, procesverbali me nr. ... i datës 17.11.2020, njoftim për të dhënat- shënimet, foto të aparatit, dorëzat, pllombat e dëmtuara, si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, janë prova të besueshme, mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri është kryerës i veprës penale Heqja, apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 406 par.1 për të cilën është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 495 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr. 181/24, me dt. 10.06.2024.

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër Aktgjykimi për dhënien Urdhrit Ndëshkimor, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim, në afat prej tetë (8) ditëve nga dita e pranimet të njëjtit, kësaj gjykate.